



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURENCËS  
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 624, Datë 31.05.2019

**“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Saudi Basic Industries Corporation nga shoqëria Saudi Arabian Oil Company”.**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Z. Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj. Leida MATJA	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 31.05.2019, shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:** Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Saudi Basic Industries Corporation nga shoqëria Saudi Arabian Oil Company.

**Baza Ligjore:** Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64. Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe formulari i njoftimit të përqendrimit”.

**Komisioni i Konkurrencës,** pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Saudi Basic Industries Corporation nga shoqëria Saudi Arabian Oil Company.

**VËREN SE :**

**Transaksioni dhe përqendrimi**

Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar në lidhje me transaksionin e përfutimit të kontrollit të shoqërisë Saudi Basic Industries Corporation nga shoqëria Saudi Arabian Oil Company.

*Pala Blerëse:* Saudi Arabian Oil Company, është një shoqëri aksionare, themeluar sipas legjislacionit të Mbretërisë së Arabisë Saudite me Nr. regjistri kryesor 2052101150, datë

27.03.2018. Shoqëria Saudi Arabian Oil Company ushtron kryesisht të gjitha aktivitetet në lidhje me fushat e energjisë, duke përfshirë industrinë e hidrokarbureve, kimikateve, industri të tjera në lidhje me të ose plotësuese për të ose çdo aktivitet tjetër brenda dhe jashtë Mbretërisë së Arabisë Saudite.<sup>1</sup>

[...]

*Pala Shitëse:* Saudi Basic Industries Corporation, është një shoqëri aksionare publike e themeluar datë 06.09.1976 sipas legjislacionit Mbretërisë së Arabisë Saudite dhe është aktive kryesisht në industrinë petrokimike, plehut, hidrokarburet, hekur, çelik, alumin, industri të tjera, projekte që përbushin nevojat e shoqërisë, si lënda e parë, marketingu i produkteve brenda dhe jashtë Mbretërisë së Arabisë Saudite.<sup>2</sup>

[...].

### **Vlerësimi i përqendrimit**

Transaksioni është një përfitim kontrolli i shoqërisë Saudi Basic Industries Corporation nga shoqëria Saudi Arabian Oil Company.

Palët në transaksion plotësojnë kriteret e përcaktuar në nenin 10 dhe nenin 12 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar dhe si rrjedhojë ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, si edhe Udhëzimit Nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, përcaktimi “treg përkatës” përfshin dy komponentë:

- I. tregu përkatës i produktit, dhe
- II. tregu përkatës gjeografik.

***Tregu përkatës i produktit:*** Sa më sipër duke qenë se transaksioni nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të Komisionit Evropian në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur.

***Tregu përkatës gjeografik:*** Për analizimin e këtij rasti *tregu përkatës gjeografik* do të konsiderohet territori i **Republikës së Shqipërisë**.

Transaksioni i propozuar është përfitim i kontrollit të Saudi Basic Industries Corporation nga Saudi Arabian Oil Company.

[...]

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe transaksioni i synuar nuk do të sjellë asnjë ndryshim në tregun shqiptar.

---

<sup>1</sup> Regjistër Ekstrakti i shoqërisë Saudi Arabian Oil Company

<sup>2</sup> Regjistër Ekstrakti i shoqërisë Saudi Basic Industries Corporation

### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

### **VENDOSI:**

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Saudi Basic Industries Corporation nga shoqëria Saudi Arabian Oil Company.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I KONKURRENCËS**